

MNN QENDRORE



MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

08 Tetor 2025

NJË SHIKIM I SHPEJTË MNN



Ngjarje historike në Kubë



Në fund të Korrikut, u zhvillua Kongresi i parë Kombëtar për Teologjinë Pastorale i Kishës së Nazaretasit në Kubë në kampusin e Seminarit Teologjik Nazaretas të Kubës (SETENAC) në Punta Brava, Havanë.

Ky takim historik, që mbledhi 300 pjesëmarrës, ofroi hapësirë për të mësuar, reflektuar dhe ripërtëritje shpirtërore të përqendruar në veprën e Frymës së Shenjtë. Sesionet kryesore u përqendruan në tre fusha kyçe: Fryma dhe Kisha (e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e Kishës së Nazaretasit në Kubë), Fryma dhe Thirrja, dhe Fryma dhe Shërbesa.

Ngjarja u planifikua dhe u organizua nga Seminari Teologjik Nazaretas i Kubës, me mbështetjen e Zyrës Rajonale të Mesoamerikës, Zyrës së Fushës Qendrore të Mesoamerikës, Zyrës Rajonale për Arsimin Teologjik dhe katër distrikteve të kishave Nazaretase në Kubë.

Kongresi u hap me një mesazh nga Dr. Carlos Sáenz, drejtor rajonal për Mesoamerikën, dhe përfshiu një fjalë të veçantë për pastorët nga Mbikëqyrësi i Përgjithshëm Nazaretas Christian Sarmiento. Deri vitet e fundit, nuk ishte e mundur që mbikëqyrësit e përgjithshëm dhe udhëheqës të tjerë globalë të kishës të hynin në Kubë ose të zhvillonin takime zyrtare ose mbledhje të këtij lloji.

Një moment tepër domethënës në këtë mbledhje historike ishte shugurimi i pesëmbëdhjetë (15) pastorëve, një dëshmi e gjallë e vitalitetit të shërbesës Nazaretase në Kubë.

Eventi përfundoi me ceremoninë më të madhe të diplomimit në historinë e Seminarit Teologjik Nazaretas të Kubës. Kishte 192 të diplomuar nga programe të ndryshme akademike dhe 51 çertifikata iu dhanë studentëve që përfunduan kurset afatshkurtra.

Përshtatur nga një përditësim misionar të ofruar nga Howard Culbertson, Profesor Emeritus i Misioneve, Universiteti Jugor Nazaretas.

Rajoni i Mesoamerikës

KUBA



Me mbërritjen e Kristofor Kolombit në 1492, popullsia vendase e Amerindianëve filloi të binte ndërsa kolonia Spanjolle zhvillohej. Me importimin e një numri të madh skllevërish Afrikanë për të punuar në plantacionet e sheqerit dhe kafesë, dhe me rritjen e pakënaqësisë ndaj sundimit Spanjoll për disa shekuj, lëvizjet për pavarësi dhe rebelimet e herëpashershme çuan në ndërhyrjen e SHBA-së gjatë Luftës Spanjolle-Amerikane në 1898, e cila i ndihmoi Kubanezët të përmbysnin sundimin Spanjoll. Traktati i Parisit i atij viti l dha Kubës pavarësinë nga Spanja. Pas tre vjet e gjysmë nën sundimin ushtarak Amerikan, Kuba u bë republikë e pavarur në 1902. Kisha e Nazaretasit filloi punën e saj në Kubë pikërisht në atë vit (1902), duke e bërë atë një nga fushat e para të misionit Nazaretas. Kuba shpërtheu në një revolucion që zgjati më shumë se pesë vjet, duke vendosur një sistem politik socialist në 1959, nën sundimin autoritar të Fidel Castros, i cili zgjati për gati pesë dekada. Sot, Kuba është kushtetueshëm, një shtet socialist Marksist-Leninist me sistem njëpartiak. Kisha e Nazaretasit ka vazhduar të rritet dhe të zhvillohet gjatë viteve, dhe Zoti është ende në veprim, duke çliruar jetë me anë të hirit të Tij dhe duke sjellë shpresë.



9,507 Anëtarë



144 Kisha të
Organizuara Plotësisht;
3 Kisha të
Paorganizuara Ende



22 Shërbëtorë të
Liçensuar dhe 76
Shërbëtorë të Shuguruar
në 3 Distrikte

LUTJE

- Lutuni që shumë njerëz të ndiejnë thirrjen e Zotit në jetën e tyre për shërbesë në Kubë, dhe që Kisha e Nazaretasit të vazhdojë të lulëzojë, duke hyrë në zona të reja pa pengesa.
- Lutuni për këtë klasë të re të shuguruarëve ndërsa ata, së bashku me shumë që u diplomuan nga Kursi i Studimit në seminar, do të fuqizohen për shërbesa të frytshme.



LAVDËRIM

- Lavdëroni Perëndinë për lëvizjen e Frymës së Tij që po shemb mure dhe po hap zemrat ndaj mesazhit të dashurisë dhe hirit të Tij në Kubë.
- Lavdëroni Perëndinë për ngjarjet historike që e kanë bërë vitin 2025 një vit të rëndësishëm në historinë e Kishës së Nazaretasit në Kubë.
- Lavdëroni Perëndinë për Seminarin Teologjik Nazaretas të Kubës dhe punën e shkëlqyer që po bën në përgatitjen e një brezi të ri shërbëtorësh për punën në Kubë.



A MUND TË SHËRBENI?

A po ju thërret Zoti t'i bashkoheni Atij në misionin e Tij të hirit në Rajonin e Mesoamerikës Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF. Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).

